



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



1	Data 22.02.16	Vendi Kaçanik
Nj. org.	Numri	Shtojcë
01	16-6419	✓

Në bazë të nenit 14 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/ 2008), të nenit 3 pika 1, paragrafi 3. lidhur me nenet 4, 5 dhe 7.3 paragrafi 1. i Ligjit Nr.04/L-144, Për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujtshme të Komunës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 35/17,dhjetor 2012), të nenit 5 të Rregullorës QRK 23/2013- Për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfytëzim dhe këmbimit të pronës së palujtshme të Komunës, të nenit 3 të Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës prej datës 08.02.2016. Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë, 15.02.2016, merr këtë:

VENDIM
PARAPRAK PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS
NË SHFYTËZIM AFATSHKURTË

1. Me këtë Vendim, ipen në shfrytëzim në **AFATSHKURTË** kohor pronat e paluajtshme të Komunës së Kaçanikut, personave fizik dhe juridik.

2. Pronat e paluajtshme të komunës të cekura si në pikën 1. të këtij Vendimi, ipen në shfrytëzim në periudhë afatshkurtë për **Pesëmbëdhjetë (15)Vite**, në Zonat Kadastrale si vijon:

1.1. Zona Kadastrale Kaçanik :

1.1.1. Ngastra kadastrale nr. 00072-1, me S=00.37.83 ha,

1.1.2. Ngastra kadastrale nr.01866-0, me S= 00.69.53 ha,

1.2. Zona Kadastrale Rekë :

1.2.1. Ngastra kadastrale nr.00105-0, me S= 00.09.30 ha,

1.2.2. Ngastra kadastrale nr. 00155-0, me, S=00.39.52 ha,

1.2.3. Ngastra kadastrale nr, 00156-0, me S=00.62.80 ha,

1.3. Zona Kadastrale Kërbliç :

1.3.1. Ngastra kadastrale nr. 00531-0 me S= 00.33.36 ha,

1.3.2. Ngastra kadastrale nr. 00015-0 me S= 00.28.43 ha.

3. Pronat e përcaktuara në ngastrat kadastrale të pikës 2. të këtij Vendimi, janë pronë e Komunës Kaçanik.

4. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës komunale është; krijimi i kushteve për zhvillim të bizneseve, krijimi i mundësisë për investime nga investitorë vendor dhe të huaj me ç'rast do të krijohen vende të reja të punës.

5. Me dhënien e pronës komunale në shfrytëzim sipas dispozitave ligjore në fuqi, komuna do të mund të inkason edhe të hyra komunale, të cilat do të konsiderohen para publike dhe i nënshtrohen dispozitave ligjore për menaxhimin e financave publike.

6. Procedura për dhënien e pronës së palujtshme të Komunës në shfrytëzim në periudhë afatshkurtë, do të bëhet përmes konkurrencës (konkursit) të hapur publik i cili konkurs do të jetë në formë të, Ankandit Publik.

6.1. Procedurat e parapara me Ligjin Nr.04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujtshme të Komunës dhe Rregullores QRK 23/2013- Për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së palujtshme të Komunës, do t'i zhvilloi, Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës, i formuar me Vendim të Kuvendit të Komunës.

7. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset, Kryetari i Komunës.

8. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokolit të autoritetit mbikqyrës-MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Vendimi iu dërgohet: MAPL, Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës, Kryetarit të Komunës, DUKMM, dhe Arkivit.

Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi

